



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 106, datë 26.03.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Oltjona Goxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: Artan Nexhipaj; Objekti: Rishikimki i vendimeve nr.795-111, datë 30.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe vendimin nr.1342, datë 20.07.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Rishikimin e vendimit penal te huaj nr 1/2003 R.G.N.R me datë 28.03.2003 të Gjykatës së Bergamos Itali për pasojë ekstradimin në Itali.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Person i interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; Objekti: Kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të datës 28.10.2020.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani (relator), si dhe gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Arnisa Këllici dhe Elisabeta Gjoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; Të pandehur: {...}; Akuzuar sipas neneve 284/2 dhe 283/2 të Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; I pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim e shitje e narkotikeve”, sipas nenit 283/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}i; Objekti: “Dërgimi për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve {...}, {...}të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 263/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: Samet Elezaj; Objekti “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290/4 i Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur{...}; Objekti: “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, neni 179 i Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Trafikimi i mjeteve motorike”, neni 141/a/2 i Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur{...}; Objekti: “Vjedhje më shumë se njëherë”, neni 134/2 i Kodit Penal.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Plagosje e lehtë me dashje”, neni 89 i Kodit Penal.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, neni 27/8 a i Kodit Penal.

8. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, neni 298/2 i Kodit Penal.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}, {...} Objekti: “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, neni 236/1 i Kodit Penal.

10. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; Objekti: “Heqje/kufizim i zotësisë për të vepruar. Heqje e përgjegjësisë prindërorë”.

11. Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.117 prot., datë 09.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për caktim gjyqtari, në çështjen civile me kërkuar: {...}, me objekt: “Lëshim urdhër ekzekutimi”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Hasan Selimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.37 viti 2020 për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.65, viti 2020 në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin {...}, akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Mirela Kore (Iliopulli)(relatore), Suela Dashi dhe Blerta Çibuku, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuzat: Kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 283/2 dhe 323/1 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Shkëlzen Liçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; të pandehur: {...}etj; Objekti: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Paulin Çera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur {...} i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278/b i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me palë paditëse {...}; I paditur: “{...}”; Objekti: Pagim dëmi.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Adrian Shega, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}, etj.; E paditur: {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, etj.; Objekti: Konstatimi i konfliktit të interesit midis paditëses {...} dhe gjyqtares {...}, në çështjen gjyqësore me palë paditëse {...}, i paditur {...}, {...}, {...}Vendore

Sarandë; Baza ligjore: neni 32,102 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenet 608, 609 e vijues 618, 619, 625 dhe 626 të Kodit Civil; Ligji me nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuzuar: për veprën penale të “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 79/c, 25, 22 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj; Akuza: Kultivim i bimëve narkotike, etj.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj; {...}; Akuza: Mashtrim.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Kultivim i bimëve narkotike, etj.

4. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: Pjestim pasurie.

5. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: Kërkesë për përjashtim gjyqtari.

6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini dhe Nazmi Troka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; Objekti: Dhënie autorizimi për të dalë jashtë shtetit për fëmijët e mitur.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me kërkues {...}; Objekti: Rishikim vendimi nr.385/2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}Të paditur: {...}, {...}; Persona të tretë {...}. pranë Qarkut Vlorë, {...}; Objekti: “Detyrim njohje trashëgimtar”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; Të paditur: {...} Shoqëria Tregtare “{...}” sh.a; Personi i

Tretë: {...} Objekti: Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të “Kërkesës për ekzekutim të detyrueshëm”, “Marrje e masës së sigurimit të padisë”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Zgjidhje martese.

4. Gjyqtari i i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Kallëzues: {...}; Person që u atribuohet vepra penale: {...}; Objekti: Pushim i procedimit penal nr.1547 procedimi, datë 04.11.2019 për veprën penale “Falsifikim i Dokumentave”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: Ankim kundër vendimit datë 13.07.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Fier për “Mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin nr. 838, datë 02.07.2020”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkues/i pandehuri: Fatmir Pjetri; Objekti: Përfundimi i gjyqësorisë së Saida Dollani dhe Dhimitër Lara nga gjykimi i çështjes penale nr.11 akti, datë regjistrimi 20.01.2021, me të pandehur {...}, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 333/a/1, 140-22 dhe nenet 28/4 e 334/1, 140 dhe 28 e 334/1, 88, 88 dhe nenet 28/4 e 334/1 dhe 278/2 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR